



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227563

Datë: 26.07.2024

Numri i dokumentit: 05984644

AC-I.-23-0002

Në çështjen juridike të:

Paditësi

Q A, nga fshati G, Komuna Viti.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

N.B.I” Agromorava, (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6928, të datës 13 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 25 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-6928, i datës 13 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 03 nëntor 2014, paditësi ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), me shenjën GJI035-0131, të datës 03.10.2014, me të cilin kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shume prej 275.00 euro për periudhën 01 janar 2004 deri 31 dhjetor 2010, ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është parashkruar.

Me ankesë, paditësi ndër të tjera ka theksuar se ka qenë i punësuar në NBI "Agromorava", për kohë të pacaktuar dhe se marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë asnjëherë derisa AKP-ja ka lëshuar letër pezullimin për përfundimin e punësimit. Bashkë me ankesën e ka dorëzuar vendimin e AL-së, GJI035-0131, të datës 03.10.2014 dhe njoftimin për ndërprerjen marrëdhënies së punës të dt. 25 nëntor 2005.

Me 10 mars 2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në ankesë ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Më tutje, ka ngritur edhe prapësimin e parashkrimit të kërkesës, duke theksuar se me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është përcaktuar se pagesa e pagës apo rrogës, apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga marrëdhënia e punës, do të parashkruhet për tri vjet. Po ashtu, përgjigja në ankesë i referohet nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, ku është përcaktuar se kërkesat apo pretendimet e pasafatshme, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, do të refuzohen si të pa baza. Me përgjigje në padi është propozuar që të refuzohet kërkesëpadija, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL.

Me 24 tetor 2022, paditësi ka dorëzuar përgjigje ndaj përgjigjes në ankesë, ku ndër të tjera ka theksuar se ka kërkuar dokumente nga AKP-ja dhe ka marrë përgjigjen se të gjitha dokumentet që kanë qenë në NSH janë djegur. Përyjashtimisht, AKP-ja

ia ka dorëzuar vetëm dy lista pagash të shkruara me dorë të lirë të vitit 2004 dhe një listë të vitit 2006, të cilat i ka dorëzuar me parashtresë.

Me 25 nëntor 2022, pala e paditur ka dorëzuar parashtresën - kundërpërgjigje, ku ndër të tjera ka theksuar: Në arkivat e NSH-së janë gjetur disa lista të punëtorëve por në ato lista nuk figuron emri i paditësi Q A, që do të thotë se ka mundësi se ai nuk ka qenë punëtorë aktiv i NSH-së në atë kohë. Bashkë me kundërpërgjigjen ka dorëzuar disa lista të punëtorëve të Ndërmarrjes, të cilave iu është referuar më sipër. E paditura ka përsëritur pretendimin e saj se kërkesa e paditësit është parashkruar.

Me 13 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6928, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadia e paditësit Q A, ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI035-0131, i datës 03.10.2014, dhe e ka obliguar Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Autoritetin e Likuidimit për N.B.I "Agromorava", që paditësit t'ia paguaj shumën prej 78.58 €, në emër të kompensimit për paga të mbetura të papaguara gjatë viteve 2004-2005, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit mbi shumën e aprovuar.

Shkalla e parë e DHPGJS ka arsyetuar se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë. Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *"Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij"*.

Që të dy palët e pranojnë faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me letrën e pezullimit të datës 25.11.2005. Por, refuzimi i kërkesës është mbështetur vetëm në një argument ligjor, respektivisht në institutin e parashkrimit. Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundimin se të gjitha faktet vendimtare të rastit janë jokontestuese, dhe se kontesti në mes të palëve është i natyrës së pastër

ligjore, ku pala e paditur ka pretenduar se kërkesa kreditore për pagat e pretenduara është parashkruar, ndërsa pala paditëse ka pretenduar se nuk ka parashkrim në këtë rast konkret. Prandaj, zgjidhja e rastit varet nga përfundimi se a është parashkruar kërkesa kreditore apo jo, duke u kufizuar në periudhën që paditësi ishte në marrëdhënie pune (2004-2005).

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritorë (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Shkalla e parë kishte konstatuar se kërkesa e paditësit është e bazuar, përkitazi me pagat që i takojnë periudhës janar 2004 – 2005, ndërsa e njëjta nuk ka bazë ligjore për pagat e tjera të kërkuara, për shkak të faktit se me datën 25.11.2005, Ndërmarrja ka hyrë në likuidim dhe se paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës përmes letër pezullimit, dhe prej asaj kohe e ka humbur statusin e punëtorit të NSH-së, nuk ka pasur të drejtën dhe as mundësinë që të punoj më tutje dhe nuk ka pasur të drejtën në marrjen e pagave të mëtejshme. Po ashtu ka konstatuar se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite"*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç. Prandaj, Shkalla e parë e DHP ka ardhur në përfundimin se nuk janë parashkruar detyrimet e të paditurës përkitazi me pagat e papaguara të viteve 2004-2005. Në përcaktimin e lartësisë së pagave mujore, gjykata ka shterur mundësitë që të nxjerrë të dhëna nga arkivat e Ndërmarrjes, pasi të dy palët në procedurë kanë

provuar që të sigurojnë prova, por nuk kanë arritur për shkak të djegies së arkivit të Ndërmarrjes. Prandaj, gjykata ka marrë për bazë pagën mesatare të kërkuar nga pala paditëse. Paditësi ka kërkuar pagat për 7 vite, në një shumë prej gjithsej 275 €, që i bie se ka kërkuar pagën mesatare prej 39.29 € në vit ($275:7= 39.29$ €). Nga kjo llogaritje, gjykata ka gjetur se paga në të njëjtën lartësi, për dy vitet e pranuar 2004 dhe 2005, është në shumën prej 78.58 € (39.29 € për vitin 2004 dhe 39.29 €, për vitin 2005), të cilën shumë gjykata e ka miratuar me këtë aktgjykim.

Me 30 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-6928, të datës 13 dhjetor 2022 dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia e paditëses si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e parashtruesit është refuzuar në bazë të parashkrimit, konkretisht në bazë të nenit 36.2.1 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e bashkuar i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 që parashikon që "pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedhë nga marrëdhënia e punës që do të jetë e parashkruar për tri vite". Autoriteti i Likuidimit thekson se gjykata ka ngatërruar çështjen të rëndësishme faktike e rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të padrejtë kështu, Autoriteti i likuidimit thekson se i ka takuar parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë dëshmi në Gjykatës apo ndonjë organ tjetër kompetent. Në këtë rast AL-ja e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme sepse parashtruesi nuk ka arritur të provojë me fakte meritën e kërkesës si të pa pranueshme sepse parashtruesi nuk ka arritur të provojë me fakte meritën e kërkesës së tij. Për sqarim të mëtejshëm, AL-ja thekson se në mënyrë të drejtë është aplikuar dispozita e nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nr.04/L-034, e cila parasheh se: "elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë ose interesi të pretenduar të kapitalit

apo pronësisë:.. kërkesa apo pretendimi është i pasaaftshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme.” Ka shtuar, aktgjykimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtresave të prezantuara gjatë procedurës.

Me 26 janar 2024, përfaqësuesi i paditësit e pranoi ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës- AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 20 gusht 2014 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara për periudhën 01 janar 2004 deri më 31 dhjetor 2010 nga N.SH N.B.I“Agromorava”, në shumë prej 275.00 €. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kundër vendimit të AL GJI035-0131, paditësi ka paraqitur ankesë në Shkallë të I-rë të DHPGJS për kompensim për pagat e papaguara në shume prej 275.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6928, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesën e paditësit, ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI035-0131, të datës 03.10.2014, dhe e ka obliguar Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Autoritetin e

Likuidimit për N.B.I "Agromorava", që paditësit t'ia paguaj shumën prej 78.58 €, në emër të kompensimit për paga të mbetura të papaguara gjatë viteve 2004-2005, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit mbi shumën e aprovuara.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka bashkangjitur: vendimin e kundërshtuar të AL, njoftimin për ndërprerjeje të marrëdhënies së punës të lëshuara nga AKM dt. 25 nëntor 2005, dy lista pagash të vitit 2004 dhe një listë të vitit 2006. Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, por vetëm ka theksuar se kërkesa e parashtruesit është refuzuar në bazë të parashkrimit, konkretisht në bazë të nenit 36.2.1 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e bashkuar i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 që parashikon që "pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedhë nga marrëdhënia e punës që do të jetë e parashkruar për tri vite".

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar, ngase se kërkesa për pagat e papaguara që i takojnë periudhës 2004-2005, nuk është parashkruar, sepse paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës me njoftimin e AKM-së me 25 nëntor 2005, dhe se paditësit me këtë njoftim i është thënë se kërkesat e tij do realizohen në procedurë të Likuidimit. Me të drejtë Shkalla e parë ka vlerësuar se gjatë periudhës nga pushimi i marrëdhënies së punës e deri në ditën e dorëzimit të kërkesës kreditore nuk ka pasur rrjedhje të afatit të parashkrimit, sepse çështja ka qenë në përgjegjësinë e AKP-së që të fillojë me procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, ndërsa paditësi ka qenë në pritje të fillimit të asaj procedure, sipas udhëzimeve që ka pranuar me letër pezullimin nga puna.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë ka shterur të gjitha mundësitë për të nxjerrë të dhëna nga arkivat e Ndërmarrjes dhe ka nxjerr informata aq sa ishte mundur nga të dy palët, andaj bazuar në provat që i kishte në dispozicion me të drejtë e ka aprovuar shumën e kërkuar prej shumën prej 78.58 € (39.29 € për vitin 2004 dhe 39.29 €, për vitin 2005), në emër të pagave të pa paguara për periudhën e

cekur, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon kompensimi i pagave të cilat i ka njohur shkalla e parë.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 23 janar 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 25 korrik 2024

Mr. Sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar kryesues _____